



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1158/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Makfirete Ademit candidate për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 2704b pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për kuvend komunal nga KQZ-ja për shkak të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur më 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Makfirete Ademit candidate për kuvendin komunal të Vushtrrisë nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtrri

Arsyetim

PZAP-i, më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Makfirete Ademi candidate për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e AAK-së me dyshimin se në vendvotimin 2711b ka pasur parregullsi pasi që në këtë vendvotim ka familjarët e saj dhe se i mungojnë votat të cilat i janë dhënë nga familjarët e saj. Parashtruesja e ankesës kërkon që të konfirmohen parregullsitë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:


Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Makfirete Ademi se në vendvotimin 2704b ka pasur parregullsi dhe se i mungojnë votat e dhëna nga familjarët e saj, këto pretendime PZAP-i konsideron si të pabazuara me prova dhe me dëshmi bindëse pasi që

parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë që do ti bënë të besueshëm pretendimin e saj të parashtruar më anë të ankesës. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1158/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.